

nr. 5, maj 2009

gap

monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

**Brenda mandatit janë inicuar 20 strategji  
zbatimi është çështje krejt tjetër**

- Aprovohet skema e “Fondit për Kuadro”, program ky i propozuar nga GAP-i.
- Udhëzimi administrativ për importimin e mishit përjashton kompanitë vendore
- Ligji për duhanin miratohet sërish, pasi që nuk ka qenë i zbatueshëm
- Miratohen rekomandimet e dala nga Rishikimi FunkSIONAL - FRIDOM

# Tungjatjeta!



Në muajin maj, Qeveria e Kosovës ka mbajtur katër takime, në të cilat ka marrë 23 vendime.

Në njërën prej mbledhjeve, Qeveria nuk ka marrë asnjë vendim, por vetëm i ka diskutuar detajet e vizitës së Nënpresidentit Amerikan, Joseph Biden.

Gjatë këtij muaji, Qeveria e Kosovës ka miratuar shtatë projektligje dhe një udhëzim administrativ.

Brenda një periudhe pesëmuajore, Qeveria e Kosovës ka miratuar nga dy herë këto tri projektligje: për TVSH-në, për Tatimin mbi të Ardhurat Personale dhe për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave.

Është marrë vendim që të rifillohet me shpronësimet në fshatin Hade, ndërsa Harilaqi i Fushë Kosovës është caktuar si lokacion për derdhjen e mbeturinave të rrezikshme.

Me një vendim, Qeveria i ka kërkuar udhëheqjes komunale në Lipjan që ta anulojë vendimin për operimin e taksistëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Sa u përket vendimeve të Qeverisë në muajt e kaluar, edhe pse Projektligjin për Prishtinën e ka miratuar në muajin maj, atë ende nuk e ka dërguar në Kuvend për miratim. Njëjtë ka vepruar edhe me Projekt-Strategjinë e Kosovës Kundër Korrupsionit 2009-2011.

Instituti GAP ka vazhduar me monitorimin e vendimeve të katër muajve të kaluar. Mirëpo, për dallim nga numrat e kaluar, kësaj radhe pasqyrimi i vijmësisë në zbatimin e vendimeve do të pasqyrohet në një tabelë, ndaras nga pjesa përshkuese e GAP Monitor. Tabela e re gjendet në webfaqen e institutit gap ([www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)) në jep një pasqyrë më të qartë rreth asaj se si ka shkuar zbatimi i vendimeve prej marrjes së tyre. Shumë vendime që janë marrë gjatë katër muajve të kaluara - nuk janë duke u zbatuar në tërësi, ose nuk kanë filluar së zbatuari fare. Për të gjitha këto dhe për vendimet tjera, ju ftojmë ta lexoni numrin e pestë të GAP Monitor, si dhe ta analizoni tabelën për zbatueshmërinë e vendimeve.

Gjithashtu, i falënderojmë të gjithë ata që na kanë kontaktuar në [monitor@institutigap.org](mailto:monitor@institutigap.org). Mirëpresim çdo koment, sugjerim, ose kritikë nga ju.

Lexim të këndshëm!

## Përmbajtja

- 3 Ngritet në 20 numri i strategjive të iniciuara gjatë këtij mandati qeverisës - zbatimi ende problem
- 4 Sërish miratohet Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave
- 5 "Fondi për Kuadro" e merr dritën e gjelbër
- 7 Ligji për duhanin nuk ka qenë i zbatueshëm, vendoset të miratohet sërish
- 8 Qeveria ndryshon udhëzimin administrativ për importin e mishit
- 9 I hapet rruga blerjes së Ambasadave të Kosovës
- 10 Reformohen administratat e tri Ministrive
- 11 Rifillon shpronësimi i Hades
- 12 Qeveria i propozon Kuvendit zgjedhjen e udhëheqësve të Zyrës Rregullative për Ujëra dhe Mbeturina
- 13 Qeveria i lejon Ministrisë së Bujqësisë rivendosjen e 372.000 eurove
- 14 Harilaqi i Fushë Kosovës zonë e deponimit të mbeturinave dhe materieve të rrezikshme
- 15 Ndhimohet me 7.000 euro familja e dëshmorit të kombit Sami Rama
- 16 Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
- 17 Miratohet Projektligji për Miniera dhe Minerale
- 18 Lejohet licencimi i studentëve biologë
- 19 Qeveria kërkon anulimin e vendimit të Komunës së Lipjanit, por Komuna nuk do
- 20 Miratohet Projektligji për ndarjen e Dekorativave nga Presidenti
- 21 Miratohet Projektligji për Tatimin në të Ardhurat Personale
- 21 Hapen përkohësisht dy pika të reja kufitare në kufirin me Shqipërinë
- 24 Kosova merr hapa të njëanshëm për lehtësimin e procesit të liberalizimit të vizave
- 25 Programi "Diaspora" mobilizon Ministrinë e Punëve të Brendshme
- 26 Përmbledhja

## Ngritet në 20 numri i strategjive të iniciuara gjatë këtij mandati qeverisës - zbatimi ende problem

Qeveria e Kosovës ka vendosur të iniciojë procedurën për hartimin edhe të dy strategjive. Me vendimet 03/66 dhe 04/66, Qeveria e Kosovës ka kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme që t'i fillojë procedurat për hartimin e Strategjisë Nacionale për Grumbullimin e Armëve të Paligjshme, si dhe Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Krimit.

Me këto dy strategji, numri i strategjive të iniciuara nga janari 2008 arrin në 20, prej të cilave 14 janë miratuar dhe gjashtë janë në

procedurë të hartimit.

Punën më të madhe në hartimin e strategjive e ka pasur Ministria e Punëve të Brendshme.

Gjatë kësaj qeverisjeje, MPB ka iniciuar hartimin e nëntë strategjive, prej tyre vetëm tri kanë hyrë në fuqi.

Numri i strategjive të iniciuara që nga janari 2008 arrin në 20, nëntë prej të cilave janë kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Raporti i Progresit 2008 për Kosovën, i realizuar nga Komisioni Evropian, në dhjetë pika kritikon Qeverinë e Kosovës për mosadaptimin e strategjive dhe moszbatimin e atyre aktuale.

Strategjia	Inicimi	Statusi
Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta.	-	Miratuar më 24.4.2008, me vendimin 08/17.
Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Genie Njerëzore 2008-2011.	-	Miratuar më 31.07.2008, me vendimin 03/29.
Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Luftë kundër Krimit të Organizuar në Republikën e Kosovës.	Iniciuar më 6.11.2008, me vendimin 08/44.	Nuk është miratuar ende.
Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Luftë kundër Terrorizmit në Republikën e Kosovës.	Iniciuar më 6.11.2008, me vendimin 09/44.	Nuk është miratuar ende.

Strategjia	Inicimi	Statusi
Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Luftë kundër Trafikimit të Narkotikëve në Republikën e Kosovës.	<b>Iniciuar më 6.11.2008, me vendimin 10/44.</b>	Nuk është miratuar ende.
Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit.	<b>Iniciuar më 8.4.2009, me vendimin 06/60.</b>	Nuk është miratuar ende.
Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit për këtë strategji.	<b>Iniciuar më 6.11.2008, me vendimin 11/44.</b>	Miratuar më 8.4.2009, me vendimin 08/60.
Strategjia Nacionale për Grumbullimin e Armëve të Paligjshme.	<b>Iniciuar më 29.05.2009, me vendimin 03/66.</b>	Sipas MPB, pritet të miratohet në tremujorin e katërt të 2009.
Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Krimit.	Iniciuar më 29.05.2009, me vendimin 04/66.	Sipas MPB, pritet të miratohet në tremujorin e katërt të 2009.

Siç shihet nga tabela e mësipërme, MPB-ja ka ende shumë punë për të bërë edhe sa i përket hartimit të katër strategjive të iniciuara më herët.

SipaszyrtarëvetëMPB-së,dallimi në mes të Strategjisë Nacionale Kundër Krimit të Organizuar dhe Strategjisë për Parandalimin dhe Eliminimin e Krimit, është se e para ka të bëjë me rastet më të rënda të krimeve, kurse e dyta me rastet më të lehta të krimeve. Gjithashtu, Strategjia për Kontrollin e Armëve të

Vogla dhe të Lehta me Strategjinë për Grumbullimin e Armëve të Paligjshme janë në ndërlidhmëni të ngushtë mes veti.

Në Raportin e Progresit 2008 për Kosovën, të Komisionit Evropian, dhjetë nga sfidat e shumta që përmenden në raport kanë të bëjnë me strategjitë dhe planet e munguara të veprimit dhe moszbatimin e strategjive aktuale. Nga moria e sfidave përmbushjen e të cilave e kërkon nga institucionet e Kosovës, Raporti i Progresit 2008

e kritikon Qeverinë e Kosovës edhe për mosnxjerrjen e një strategjie dhe plani të veprimit për grumbullimin e armëve të paligjshme dhe një strategjie për luftimin e krimit të organizuar. Qeveria e Kosovës është vonuar në adaptimin e këtyre strategjive dhe miratimi i tyre nuk pritet të ndodhë para Raportit të Progresit 2009 dhe studimit të fizibilitetit. Edhe këtë vit, Kosova do të kritikohet për mosmiratimin e këtyre dy strategjive.

## Sërish miratohet Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave

Projektligji i ri për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, i miratuar në Qeveri gjatë muajit maj, do të zëvendësojë në tërësi Ligjin 03/L-113 për të Ardhurat e Korporatave, aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, më 18 dhjetor 2008. Arsyetimi për këtë miratim të sërishëm të këtij projektligji, ashtu siç ishte edhe arsyetimi për Projektligjin

gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimet e legjislacionit të përbashkët të Bashkimit Evropian. Disa nga çështjet kryesore të cilat projektligji i avancojnë më tutje, në krahasim me legjislacionin në fuqi, janë: çështja e dividendës, zhvlerësimi, borxhi i keq, si dhe çështje të tjera. Projektligji është hartuar konform

(IPA). Gjithashtu, do të plotësojë çështjen e të hyrave të pallogaritura, si dhe garanton lirime të veçanta tatimore për mallrat që shërbejnë për përdorime religjioze, ashtu siç është e specifikuar në Pakon e Ahtisaarit dhe në Ligjin 02/L-31 për Liritë Religjioze në Kosovë.

Është me rëndësi të ceket se çdo marrëveshje dypalëshe, e nënshkruar nga Ministri i MEF-it për eliminimin e tatimit të dyfishtë, do të jetë mbi dispozitat e këtij ligji.

Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave, i miratuar në dhjetor 2008, zëvendësoi Rregulloren e UNMIK-ut 2004/51 dhe uli shkallën tatimore nga 20% në 10%. Projektligji e mban këtë shkallë tatimore edhe më tutje, si dhe bën disa zbritje shtesë tatimore. Kjo do të ndikojë në të uljen e të hyrave buxhetore për tre vjetët e ardhshëm, në masën prej 1.7 milion euro.

Në një hark kohor prej pesë muajsh, Qeveria e Kosovës miraton dy herë Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Projektligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale

për TVSH-ne - i miratuar në muajin e kaluar, si dhe Projektligjin për Tatimin mbi të Ardhurat Personale - për të cilin do të flasim më poshtë, është se projektligji i ri është më

Direktivave të BE nr. 2003/123 dhe nr. 2006/98, të cilat trajtojnë çështjet e dividendës. Për më tepër, projektligji synon që të harmonizojë legjislacionin tatimor me kërkesat e Instrumentit për Para-Anëtarësim

qëllim të sigurimit të shkathtësive për pozita deficitare në shërbimin publik, zbatohet Skema e Fondit të Trurit.

zbatohet propozimi për krijimin e një numri të caktuar të posteve të specialistëve në nivelit të lartë në ato fusha, ku nevojat rreth politikave me prioritet të identifikuar nga qeveria janë më të mëdha.

Këto pozita do të kualifikohen për një pagë më të lartë, në shkallën prej 800 deri në 1800 euro në muaj. Kriteret precize për pagesën e shtesave si dhe për propozuar të përzgjedhjes janë dhënë në raportin e GAP-it, të bashkanguluar në këtë vendim.

## Skema e “Fondit për Kuadro” e merr dritën e gjelbër

Më 24 dhjetor 2008, me vendimin 02/48, Qeveria e Kosovës ka miratuar skemën e “Fondit për Kuadro”. Skema e fondit është një propozim i bërë nga Instituti për Studime të Avancuara GAP.

institucionet vendore nuk kanë qenë atraktive edhe për faktin se pagat në sektorin publik nuk janë konkurruese me sektorin privat dhe institucionet ndërkombëtare në Kosovë. Pagat më të larta në sektorin publik zakonisht

deficitare dhe me më shumë nevojë, si Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shëndetësisë, do të kishte pozita të caktuara në departamentet kryesore ku do të angazhoheshin individë të kualifikuar.

‘Fondi për Kuadro’ është program i cili synon angazhimin e 150 deri 200 profesionistëve në administratën shtetërore të Kosovës. Sipas programit, këta profesionistë do të marrin një pagesë të mjaftueshme që do ta parandalojë ikjen e kuadrove nga administrata shtetërore në sektorët privatë dhe në organizatat ndërkombëtare

Pagesa për këto pozita do të duhej të ishte më e lartë dhe rekrutimet të bëheshin në mënyrë të ndryshme nga rekrutimi i stafit civil, sipas normave në fuqi.

Sipas propozimit të Institutit GAP, pagat për këto pozita do të duhej të ishin mes 1200 – 1500 euro. Është me rëndësi që e tërë skema të administrohet nga një autoritet qendror, i vendosur në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike (tash Ministria e Administratës Publike).

Qëllimi i kësaj skeme është krijimi i një fondi për financimin e një numri prej 150-200 profesionistëve në shërbimin civil të Kosovës. Aktualisht, profesionistët e kualifikuar kosovarë zakonisht angazhohen në sektorin privat, ose në institucionet ndërkombëtare aktive në Kosovë. Për ta,

janë të ndërlidhura me postet politike, kurse shumë individë të kualifikuar nuk dëshirojnë të identifikohen me politikën.

Për ta bërë të mundur që Kosova të mund të tërheqë sa më shumë individë të kualifikuar apolitikë në shërbimin civil, Instituti GAP ka propozuar një skemë të veçantë, ku në sektorët

Për funksionimin e skemës së “Fondit për Kuadro” është e nevojshme që të zbatohet një proces i ndershëm i rekrutimit, duke marrë parasysh rekrutimet vetëm në pozitat të rëndësishme, si ato për udhëheqësi të njëjseve dhe departamenteve, por

edhe rekrutimin e njerëzve profesionistë që mund të jenë bartës të reformave në sektorin e administratës publike në Kosovë. Zbatimi i drejtë i kësaj skeme mund ta kthejë administratën publike në një sektor atraktiv për të punuar, duke tërhequr individët e kualifikuar që aktualisht janë të angazhuar në sektorin privat, ose në institucionet ndërkombëtare.

Skema e "Fondit për Kuadro" është edhe një mbështetje e projektit të Ministrisë së Arsimit për "Thithjen e Trurit" (Brain Gain). Profesionistët kosovarë që kanë

mbaruar studimet në universitet e njohura jashtë vendit, mund të kthehen në Kosovë përmes programit "Brain Gain", ndërsa pozitat e tyre në shërbimin civil të financohen përmes skemës së "Fondit për Kuadro". Shembuj të tillë të skemës së "Fondit për Kuadro" mund të gjenden edhe në administratat e vendeve tjera, si për shembull, në Britaninë e Madhe ("Fast Stream Program").

Kjo skemë e aprovuar nga Qeveria e Kosovës në dhjetor të vitit të kaluar, parashihte që si pilot

projekt për testimin e skemës të merrej Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Njësia për Partneritetin Publiko-Privat, të dyja këto në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Vendimi i Qeverisë, gjithashtu, parashihte që pagat për këtë skemë të ishin nga 800 deri 1800 euro. Vendimi 07/63, i marrë më 7 maj 2009, e shtyn edhe më tutje skemën e "Fondit për Kuadro". Me këtë vendim caktohet niveli maksimal i shpërndarjes së mjeteve financiare.

Numri i posteve dhe mjetet financiare që do të për zbatimin e skemës "Fondi për Kuadro"

	Organizata Buxhetore	Shuma	Statusi
1	Zyra e Kryeministrit	100.000 €	5-11
2	Ministria e Arsimit	80.000 €	4-8
3	Ministria e Drejtësisë	80.000 €	4-8
4	Ministria e Ekonomisë dhe Financave, duke përfshirë Administratën Tatimore të Kosovës, Doganat dhe Transferet automatike të Njësies së Makroekonomisë dhe Partneritetin Publiko-Privat	300.000 €	14-31
5	Ministria e Shëndetësisë	80.000 €	4-8
6	Ministria e Transportit	80.000 €	4-8
7	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	80.000 €	4-8
8	Ministritë tjera, gjithsej 11 (25.000 € secila)	275.000 €	13-29
	<b>Totali</b>	<b>1.075.000 €</b>	<b>50-112</b>

Sipas propozimit të GAP, e tërë skema e "Fondit për Kuadro" duhet të menaxhohet nga një autoritet qendror i vendosur në Ministrinë e Administratës Publike. Arsyesitimpërkëtëkaqenë se Zyra e Kryeministrit është e tejngarkuar me detyra të shumta dhe nëse autoriteti qendror vendoset në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, mund të ndodhë që kjo skemë të mos menaxhohet në mënyrën e duhur. Kurse, sipas vendimit të Qeverisë, ky autoritet është emërtuar "Menaxheri i Projektit

të Fondit për Kuadro" dhe është vendosur pikërisht nën autoritetin e Zyrës së Kryeministrit. Skema për "Fondin e Kuadrove" do të kushtojë 1.075.000 euro, kurse e tërë skema do të ketë 50-112 përfitues. Menaxheri i skemës do të ketë një pagë mujore prej 800 euro.

Funksionimi i skemës do të varet shumë nga procesi i rekrutimit. Për këtë qëllim, GAP ka propozuar 13 hapa që duhet ndjekur për rekrutimin e individëve në këtë skemë. Mbetet të shihet sa do t'i ndjekë Qeveria këta hapa të rekrutimit të drejtë. Edhe pse ky vendim është marrë

në mbledhjen e 7 majit 2008, ai fillimisht nuk është publikuar së bashku me vendimet tjera nga e njëjta mbledhje, por i është bashkangjitur vendimeve më vonë.

Një nga propozimet e Institutit GAP ka qenë dhënia e një publiciteti sa më të madh në media, krijimi i një ueb faqe vetëm për këtë qëllim, hapja e diskutimeve për të, etj., me qëllim që publiku i gjerë të informohet sa më shumë me këtë skemë.

Mirëpo, deri më tash një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe mediat nuk kanë raportuar fare për këtë skemë.



## Ligji për duhanin nuk ka qenë i zbatueshëm, vendoset të miratohet sërish

Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Duhanin. Ligji për Duhanin është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 3 tetor 2005, dhe ka hyrë në fuqi më 9 janar 2007, pas shpalljes nga ana e PSSP-së. Ky ligj përmban 13 nene.

Që nga hyrja e tij në fuqi, ligji nuk është zbatuar fare. Ky fakt pranohet

10 mg monoksid të karbonit për një cigare. Testimet për katranin, nikotinën dhe monoksidin e karbonit bëhen në laboratorët e Ministrisë së Shëndetësisë.

Çdonjësiepaketimittëprodhimeve të duhanit duhet t'i ketë këto vërejtje: "Duhani vret"; "Pirja e duhanit dëmton seriozisht shëndetin e juaj dhe të rrethit tuaj"; "Pirja e duhanit

edhe masat ndëshkimore për mosrespektimin e dispozitave të këtij ligji. Për shembull, çdo person zyrtar që pi duhan në institucion publik dënohet me 5% të uljes së pagës. Asnjë nga dispozitat e mësipërme nuk është implementuar.

Ministria e Shëndetësisë nuk ka laborator ku do të mund ta testonte përqindjen e katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit në cigare; të rinjtë nën 18 vjet lirisht mund të shesin, blejnë dhe pinë duhan. Zyrtarët publikë pa asnjë pengesë pinë duhan në vendet e tyre të punës. Madje, ka raste kur vetë deputetët të cilët e kanë miratuar ligjin - e shkulin atë. Për shembull, në hyrje të objektit komunal në Komunën e Podujevës ndodhet një aparat për shitjen automatike të cigareve, kurse Kryetari i Komunës ka qenë pjesë e Komisionit Funkcional në Kuvendin e Kosovës për miratimin e këtij ligji. Në komisionet parlamentare, sidomos në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në çdo takim pihet duhani. Gjatë disa hulumtimeve të njëpasnjëshme që kemi bërë në komunat e ndryshme të Kosovës, kemi vërejtur se në çdo ndërtesë komunale pihet duhan, madje edhe shërbyesit civilë që kanë punë të drejtpërdrejtë me palë,

Ende pa filluar zbatimin e Ligjit për Duhanin, kërkohet ndryshimi dhe plotësimi i tij. Ndryshimet që parashihen të bëhen nuk kanë të bëjnë me përmirësimin e dispozitave të pazbatueshme, ngase ligji ende nuk ka filluar të zbatohet si pasojë e mosgatishmërisë së institucioneve. Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Duhanin nuk e ndryshon aspak përmbajtjen kryesore të ligjit në fuqi

edhe nga vet zyrtarët qeveritarë. Edhe pse Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin në tetor 2005, në nenin 3.2 thuhet se ligji do të fillojë së zbatuari nga 1 janari 2005. Pra, parashihej që ligji të zbatohet në formë retroaktive nga 1 janari 2005, kurse realisht ligji ka hyrë në fuqi dy vjet më vonë (janar 2007).

Sipas ligjit, ndalohet qarkullimi i cigareve të cilat përmbajnë më shumë se 10 mg katran për një cigare, më shumë se 1 mg nikotinë për një cigare dhe më shumë se

shkakton kancerin", etj. Ndalohet reklamimi dhe promovimi në çfarëdo forme i prodhimeve të duhanit nga çdo person fizik ose juridik. Ndalohet shitja ose ofrimi i prodhimeve të duhanit nga personat nën 18 vjeç dhe për personat nën këtë moshë. Në vendet ku shitet duhani, duhet të vendosen shenja dalluese ku shkruhet se ndalohet shitja e duhanit për personat nën 18 vjeç. Ndalohet shitja, ose ofrimi i duhanit përmes makinave automatike shitëse.

Ligji, gjithashtu, parasheh

si për shembull ofiqaria, nuk e ndalon duhanin gjatë orarit të punës.

Përmendëm këta shembuj për të dhënë një pasqyrë se Ligji për Duhanin shkelet po aq shumë nga ana e zyrtarëve publikë, sa edhe nga qytetarët tjerë.

Ndryshimet që i janë bërë këtij ligji përmes Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Duhanin, janë shumë sipërfaqësore dhe nuk e ndryshojnë aspak materien e ligjit. Moszbatimi i Ligjit për Duhanin nuk ka ndodhur si pasojë e defekteve të ligjit, por si pasojë e pavullnetit të zyrtarëve publikë për ta zbatuar ligjin. Me ndryshimet që janë propozuar,

thuhet se ligji do të hyjë në fuqi nga 1 janari 2010 (në vend të 1 janarit 2005, siç ishte në draftin e kaluar).

Ndryshimet tjera kanë të bëjnë vetëm me përmirësime të vogla gjuhësore dhe asgjë më tepër. Edhe në memorandumun shpjegues të Ministrisë së Shëndetësisë, nuk jepet asnjë shpjegim për nevojën e ndryshimit të ligjit. Me një fjalë, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Duhanin është miratim i sërishëm i Ligjit për Duhanin. Me rastin e miratimit të Ligjit për Duhanin, afro katër vjet më parë, Qeveria nuk kishte përlogaritur deklaratën financiare për këtë ligj.

Tash, me projektligjin e ri të dërguar në Kuvend, është bashkangjitur edhe deklaratata financiare. Sipas deklaratës financiare, për katër vjet, nga 2009 deri 2012, ligji do të ketë një kosto buxhetore 880.000 euro. Në vitin 2009 do të shpenzohen 20.000 euro për përgatitjet për zbatimin e ligjit; në 2010 do të shpenzohen 600.000 euro për blerjen e laboratorit për testimin e duhanit dhe punësimin e pesë vetave; kurse në vitet në vazhdim do të shpenzohen nga 130.000 euro në vit për implementimin e ligjit. Kjo shumë nuk është përfshirë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2010-2012.

## Qeveria ndryshon udhëzimin administrativ për importin e mishit

Në muajin prill, Qeveria e Kosovës ka aprovuar kërkesën e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës që të amendamentojë Udhëzimin Administrativ 18/2005, për Kontrollin Veterinar të Importimit, Kalimit Transit të Produkteve Ushqimore dhe Joushqimore me Origjinë Shtazore të Kafshëve të Gjalla dhe të Materialit për Mbarështimin e Kafshëve.

Arsyetimi për këtë ndryshim ishte se udhëzimi administrativ duhet të jetë në përputhje me Ligjin për Ushqimin, i cili është miratuar nga Kuvendi, në mars të vitit 2009.

Në muajin maj, Qeveria e Kosovës aprovoi Udhëzimin Administrativ nr. 07/2009, për amendamentimin e udhëzimit 18/2005. Mirëpo, në pjesën hyrëse të udhëzimit administrativ 07/2009, askund nuk thuhet se ky udhëzim administrativ mbështetet në Ligjin për Ushqimin, por vetëm në Ligjin për Veterinarinë dhe në

kërkesate Bashkimit Evropianë në lidhje me Menaxhimin e Integruar të Kufijve.

Sipas udhëzimit administrativ, importimi i mishit nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian lejohet vetëm nga thertoret dhe fabrikat e përpunimit të mishit të cilat nga Komisioni Evropian e kanë të aprovuar numrin për eksport dhe e kanë certifikatën e origjinës së produktit, faturën dhe

dokumentacionin tjetër të nevojshëm, i cili e dëshmon rregullshmërinë shëndetësore të produktit.

Lejohet importimi i mishit nga shtetet e Amerikës Latine, Australisë, Zelandës së Re, Turqisë dhe vendeve të treta, por vetëm nga ato thertore dhe fabrika që janë në listën e aprovuar nga Bashkimi Evropian për importet. Lejohet, gjithashtu,

ngarkohet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës (AUV).

Në bazë të Ligjit për Ushqimin, AUV është agjenci në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Është e pakuptimtë pse një agjenci e tillë duhet të jetë e lidhur direkt me Zyrën e Kryeministrit, e jo me Ministrinë e Bujqësisë, ose Ministrinë e Shëndetësisë.

Në bazë të Ligjit për Gazetën

Një muaj pas miratimit të Ligjit për Ushqimin, Qeveria merr masa që t'i amendamentojë edhe udhëzimet administrative në fuqi. Ky është një përjashtim, ngase zakonisht kalojnë shumë vjet derisa Qeveria e Kosovës t'i kompletojë obligimet e saj sa i përket legjislacionit sekondar. Udhëzimi administrativ i përjashton kompanitë vendore nga procesi për importin e mishit

importimi i mishit nga SHBA dhe Kanadaja, në bazë të marrëveshjeve bilaterale të Kosovës me këto dy vende.

Për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ do të publikohet një tender ndërkombëtar. Udhëzimi administrativ përjashton nga procesi kompanitë vendore për importin e mishit, pasi që shprehet decidivisht se kjo e drejtë tani e tutje do t'u jepet vetëm kompanive ndërkombëtare.

Për zbatimin e këtij udhëzimi

Zyrtare, aktet normative të Qeverisë duhet të publikohen në Gazetën Zyrtare të Kosovës, por një gjë e tillë nuk ndodh me udhëzimet administrative. Edhe pse udhëzimet administrative rregullojnë çështje me rëndësi për jetën e qytetarëve të Kosovës, siç është ky udhëzim administrativ, sigurimi i këtyre udhëzimeve është tepër i vështirë, pasi këto akte nuk janë të publikuara askund.





## I hapet rruga blerjes së Ambasadave të Kosovës

Në shkurt të këtij viti, Qeveria e Kosovës ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme për ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik.

Ndryshimet duheshin bërë për arsyen se ligji aktual nuk mbështeste prokurimin jashtë vendit, e si pasojë – MPJ nuk ka mundur që të blejë objektet për Ambasada dhe Konsullata.

Në Projektligjin për Amendamentimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurim Publik, me të cilin mund të nisen procedurat për blerjen e objekteve të Ambasadave dhe Konsullatave, Qeveria nuk ka përfshirë edhe vërejtjet e dhëna nga Raporti i Progresit 2008, për atë se disa dispozita të ligjit nuk janë në përputhje me parimet e legjislacionit të përbashkët të BE-së

Pas tre muajsh nga marrja e vendimit për ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik. Sipas ndryshimeve të parapara, MPJ dhe shefat e misioneve diplomatike dhe konsullore, ose të autorizuarit e tyre, kanë të drejtë që të nënshkruajnë kontratat me vlera të vogla dhe të mëdha. Nëse Ambasada ose Konsullata e Kosovës ka nevojë për blerjen të automjeteve, atëherë duhet të dërgojë tek MPJ kërkesën me më shumë se një ofertë, dhe në

raste të tilla MPJ formon një komision të brendshëm prej tre anëtarësh - i cili bën vlerësimin e kërkesës dhe jep aprovimin ose refuzimin për fillimin e negociatave për blerje. Për blerjen e objekteve për misionet diplomatike/konsullore, paraprakisht merret vendim nga Qeveria. Pas vendimit, Qeveria cakton një komision profesional për zhvillimin e negociatave me subjektin që shet

pronën (objektin). Pasuria e luajshme dhe e paluajshme e misioneve diplomatike dhe konsullore është pasuri e Republikës së Kosovës. Ministria e Punëve të Jashtme mban evidencën e të gjithë pasurisë së luajshme dhe paluajshme të misioneve diplomatike/konsullore.

Siç shihet nga ndryshimet e bëra, në rastin e Ambasadave dhe Konsullatave do të aplikohen procedura të tjera nga ato të zakonshmet. Përderisa me rastin e blerjeve brenda Kosovës nënshkrimi i kontratave bëhet nga zyrtarët e prokurimit në secilën agjenci

buxhetore dhe të cilët duhet të jenë të certifikuar, në rastin e misioneve jashtë vendit nënshkrimi i kontratave bëhet nga vetë shefi i misionit diplomatik ose konsullor.

Pasi që në këtë rast procedurat e prokurimit janë të ndryshme, edhe procedurat e auditimit do të jenë të ndryshme.

Ligji për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës nuk parasheh auditimin e Ambasadave dhe Konsullatave. Mirëpo, nënkuptohet se auditimi do të bëhet edhe për këto njësi buxhetore, pasi që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm auditon të gjitha agjencitë që financohen nga Buxheti i Kosovës. Shefi i Zyrës së Auditorit Gjeneralshpreh se auditimi për Ambasadat dhe Konsullatat do të përfshihet në raportin e auditimit për MPJ.

Kur jemi tek Ligji për Prokurimin Publik, vlen të theksohet se në Raportin e Progresit për Kosovën 2008 të Komisionit Evropian thuhet se Ligji për Prokurimin Publik nuk është në përputhje me standardet e legjislacionit të përbashkët të Bashkimit Evropian.

Qeveria nuk ka paraparë ndryshimet e nevojshme për ta bërë këtë ligj kompatibil me parimet e BE-së, ndonëse kjo është kërkuar edhe me Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian 2008.

## Reformohen administratat e tri Ministrive

Qeveria e Kosovës ka bërë Q edhe një hap në reformimin e administratës publike. Pas miratimit të Projektligjit për Shërbimin Civil dhe Projektligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, të cilat synojnë të vendosin rregull në funksionimin e shërbimit civil në Kosovë, tash, në maj 2009, Qeveria mori vendim që të fillohen reformat në administratat e tri Ministrive: Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Shërbimeve Publike (MSHP) dhe Ministrinë e Administrimit të Pushetëtit Lokal (MAPL).

Vendimi i Qeverisë për fillimin e reformave në këto tri Ministri, në fakt, është miratim i rekomandimeve të dala nga procesi i rishikimit funksional dhe organizimit funksional. Një vit më parë, më 30 maj 2008, Qeveria e Kosovës me vendimin 04/22, ka formuar Komisionin Ndërmintor për Reformën në Administratën Publike, i cili ka pasur për detyrë që në bashkëpunim me projektin FRIDOM të bëjë rishikimin funksional të të gjitha Ministrive dhe të dalë me rekomandime për hapat e më tutjeshëm që duhet të merren. FRIDOM është shkurtësuar për Rishikimin Funksional dhe Organizimin Institucional të Ministrive, një projekt në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike.

Brenda gjashtë muajve nga marrja e këtij vendimi të Qeverisë, do të ndërmerren një sërë reformash.

Ministria e Shërbimeve Publike do të shndërrohet në Ministri të Administratës Publike (MAP). MAP do të jetë përgjegjëse për procesin e reformimit të administratës publike. Mirëpo, deri në nxjerrjen e Rregullores për Organizimin dhe Strukturimin e MAP, kjo Ministri do të funksionojë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19, për degën ekzekutive të IPVQ-ve. Departamentet dhe divizionet e

Me ndryshimet e ndërmarra, Ministria e Shërbimeve Publike do të shndërrohet në Ministri të Administratës Publike.

gjertanishme në kuadër të MSHP-së do të ristrukturohen në bazë të rekomandimeve të dala nga rishikimi funksional. Agjencia Kadastrale e Kosovës, e cila deri më tash ka funksionuar në kuadër të MSHP, do t'i kalohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Departamenti për Administratë Qendrore, deri më tani që ka ekzistuar në kuadër të MSHP, do të shkrihet në tërësi dhe divizionet e tij do të ristrukturohen dhe administrohen drejtpërdrejt nga Sekretari i Përhershëm i MAP. Përveç reformave në MSHP, reformat parashihen edhe në kuadër të MPB.

MPB duhet ta themelojë Agjencinë për Regjistrimin Civil, që do t'i ofrojë të gjitha shërbimet për qytetarët dhe rezidentët të cilët aplikojnë për kartela identiteti, pasaporta, nënshtetësi, dokumente për gjendje civile, patentë-shoferë dhe dokumente për regjistrimin e automjeteve. Në vendim nuk thuhet asgjë për atë se si do të shkrihen departamentet e gjertanishme të regjistrimit dhe dokumenteve në këtë agjenci.

Por, në "Raportin Analitik për Rishikimin Funksional të MPB", thuhet se Agjencia për Regjistrimin Civil duhet të ngrihet mbi bazën e departamenteve ekzistuese të regjistrimit dhe lëshimit të dokumenteve.

Gjithashtu, sipas vendimit 04/63, MPB duhet të themelojë një departament për ta koordinuar hartimin dhe zbatimin e politikave dhe monitorimit të Policisë së Kosovës, Inspektoratit të Policisë së Kosovës dhe Qendrës Kosovare për Edukim dhe Zhvillim. Kërkohej që shërbimet e zjarrfikësve të hiqen nga menaxhimi i deritashëm i komunave dhe të krijohet një agjenci unike për Zjarrfikës dhe Reagim Emergjent, në kuadër të MPB. Ndër të tjera, MPB do ta themelojë edhe Departamentin për Nënshtetësi, Azil dhe Migracion. MAPL do të fillojë me përgatitjet dhe aplikimin e strategjisë së re për zhvillimin e burimeve njerëzore për

t'i përforcuar kapacitetet ministrore.

Vendimi 04/63 nuk i ka marrë parasysh të gjitha vendimet e bëra nga FRIDOM. Por, sipas FRIDOM, kjo pritet të bëhet në mënyrë graduale dhe në disa faza, ngase nuk mund të pritet një reformë e menjëhershme në këtë sektor. Arsyeja për këtë është se administrata shtetërore e Kosovës është njëkohësisht edhe sektori më i madh punëdhënës në Kosovë, dhe me reformat që do të ndërmerren pritet shuarja e disa

nivelin qendror, Qeveria ka marrë vendim edhe për reformimin e administratave të komunave të Kosovës.

Më 10 prill 2008, Qeveria e Kosovës ka formuar një grup ndërministror për caktimin e numrit të punonjësve në të gjitha administratat komunale. Ky grup ndërministror paraqiti një raport për numrin e punonjësve që duhet të kenë administratat komunale. Raporti u miratua në dhjetor, me

tyre të punësojnë një shërbyes civil për 750 banorë. Kurse, komunat që kanë më pak se 100.000 banorë, kanë të drejtë që në administratat e tyre të kenë të punësuar një shërbyes civil për 620 banorë. Sipas kësaj skeme, nga 33 komunat ekzistuese, 23 komuna duhet të pranojnë staf të ri për t'i përplotësuar administratat e tyre, kurse 10 komuna duhet të largojnë staf.

Deri më tash, është parë se më vështirë është të zbatohen reformat në komunat ku duhet larguar disa punonjës, sesa në ato ku duhet pranuar punonjës të rinj.

Në komunat ku parashihet largimi i stafit, ky vendim ende nuk ka filluar së zbatuari.

Mbetet të shihet se sa do të implementohet vendimi për reformimin e administratave të tri Ministrive.

Do të ketë edhe më tutje raporte nga FRIDOM sa i përket reformimit të administratave të ministrive dhe agjencioneve tjera në nivel qendror dhe pritet të ketë edhe vendime tjera të Qeverisë për reformimin e administratës qendrore.

Edhe pse që nga 17 shkurti 2008, i kemi Institucionet e Republikës së Kosovës, ekzekutivi ende funksionon me rregulloret për degën e ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse. Ministria e Administratës Publike do të funksionojë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19, mbi degën ekzekutive të IPVQ-ve

vendeve të punës dhe risistemimi i vendeve të punës.

Përveç reformave që do të ndërmerren në administratën në

vendimin 10/46. Sipas këtij vendimi, Komunat e Kosovës të cilat kanë mbi 100.000 banorë (7 komuna), kanë të drejtë që në administratat e

## Rifillon shpronësimi i Hades

Në mbledhjen e saj të 66-të, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të lejohet Korporatën Energjetike të Kosovës që të bëjë shpronësimin dhe kompensimin e pronës dhe pasurisë së banorëve të fshatit Hade, përkatësisht të ngastrave kadastrale të lagjes Shalaj, për të mundësuar zgjerimin e Mihjes së Sibovcit Jugperëndimor.

Qeveria ka vendosur të formojë një komision të veçantë për zbatimin e këtij vendimi, i cili do të bëjë incizimin dhe vlerësimin e ekonomive familjare. Ky komision do të përbëhet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, KEK-u dhe Komuna e Kastriotit.

Patundshmëritë e shpronësuara do të barten në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

KEK-u ka bërë të ditur se ka siguruar nga Qeveria edhe mjetet e tij vetanake, mjetet për vazhdimin

e projektit për hapjen e Sibovcit Jugperëndimor. Sipas KEK-ut, me miratimin e Ligjit për Shpronësim, janë plotësuar edhe kushtet ligjore për të filluar këtë proces.

Numri i pronave që do të shpronësohen është 81. Sipërfaqja e përgjithshme që do të shpronësohet është 11 hektarë, 22 ari, e 61 metra katror dhe përfshin 73 objekte banimi.

Kostoja e shpronësimit është 4 milionë euro, të siguruar nga Buxheti i Kosovës.

Ndryshe, Qeveria e Kosovës, me vendimet nr. 4/119 të datës 3 nëntor të vitit 2004, si dhe me vendimin nr 02/57 të datës 13 mars të vitit 2009, ka shpallur Zonë të Interesit të Veçantë Ekonomik fushën e Mihjes së Re - me një sipërfaqe prej 143,254 kilometra katror. Zona e Interesit përfshin Komunën e Kastriotit, atë të Fushë Kosovës, të Vushtrisë dhe Drenasit.

Kërkesa e KEK-ut për shpronësimin e pronës dhe pasurisë së banorëve të lagjes Shalaj të fshatit Hade është miratuar, përkundër pohimeve të Qeverisë se do të ndërpresë shpronësimin derisa të vërtetohet se çfarë keqpërdorimesh janë bërë gjatë mandatit të Qeverisë së kaluar me rastin e shpronësimit të banorëve të Hades. Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk ka dalë publikisht të flasë për keqpërdorimet e zbuluara.

Pas vendimit të Qeverisë për të rinisur shpronësimin, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë të ditur se vendimi për formimin e komisionit profesional do të nxirret në fund të kësaj jave, ose në fillim të javës së ardhshme, varësisht nga konfirmimet e emrave për anëtarë që do të propozohen nga institucionet tjera që janë përcaktuar sipas vendimit të Qeverisë.



## Qeveria i propozon Kuvendit zgjedhjen e udhëheqësve të Zyrës Rregullative për Ujëra dhe Mbeturina

Me vendimin 05/63, Qeveria e Kosovës ia ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës Raif Preteni, për Drejtor të Zyrës Rregullative të Ujësjellësit dhe Mbeturinave dhe Kero Bardhajn, për zëvendës drejtor të kësaj zyre.

Në mungesë të drejtorit, deri më tash përgjegjësitë e menaxherit i ka kryer zëvendës drejtori i kësaj agjencie, Afrim Lajçi.

Zyra Rregullative e Ujësjellësit dhe Mbeturinave (ZRRUM) është themeluar në vitin 2004, me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/4 mbi veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave. Sipas kësaj rregulloreje, ZRRUM është organ i pavarur, i cili ka drejtorin dhe zëvendës drejtorin, kuadrin profesional dhe nëpunësit.

Drejtori dhe zëvendës drejtori, sipas rregullores, emërohen nga PSSP.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës në mënyrë të përsheptuar, së bashku

me ligjet e Pakos së Ahtisaarit, miratoi Ligjin Nr. 03/L-086 me të cilin amendamenti Rregulloren e UNMIK-ut dhe e shndërroi atë në ligj të Kosovës.

Sipas ligjit të Kuvendit të Kosovës,

zëvendës drejtori i ushtron përgjegjësitë e menaxherit të ZRRUM.

Rekomandimi i Qeverisë së Kosovës për drejtor dhe zëvendës drejtor të kësaj zyre do të

“Në bazë të CV-ve të dërguara në Kuvend, Raif Preteni dhe Kero Bardhajn nuk janë profesionalisht të përgatitur për të udhëhequr me Zyrën Rregullative të Ujësjellësit dhe Mbeturinave. Ushtruesi i deritashëm i detyrës, Afrim Lajçi nuk është propozuar nga Qeveria, edhe pse ai është inxhinier i diplomuar dhe ka përvojë 20 vjeçare.

ZRRUM është agjencion i pavarur që i raporton Kuvendit të Kosovës. Drejtori dhe zëvendës drejtori emërohen nga Kuvendi i Kosovës, pas rekomandimit të Qeverisë për një mandat pesëvjeçar. ZRRUM duhet të menaxhohet nga drejtori, i cili sipas këtij ligji, “përveçse e menaxhon dhe mbikëqyrë funksionimin e përditshëm të ZRRUM, është i autorizuar të marrë vendime rregullatore”.

Në mungesë të drejtorit,

shqyrtohet në qershor nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, i cili pastaj do t’ia paraqesë Kuvendit të Kosovës raportin me rekomandim.

Nga CV-të e kandidatëve që i ka siguruar Instituti për Studime të Avancuara GAP, shihet se Raif Preteni para se të propozohet në këtë pozitë ka punuar si zëvendës shef i Departamentit të Planifikimit dhe Analizës në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së, dhe ka pasur titullin

“kolonel”. Këtë pozitë ai e mbajtur për dhjetë vjet, ndërkaq më herët ka punuar si shef i administratës në Shërbimin Policor të Pejës. Me profesion është jurist i diplomuar.

Kero Bardhaj, po ashtu jurist me profesion, ka punuar fillimisht

në Prokurorinë Publike të Qarkut në Prishtinë, pastaj në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë dhe në ndërmarrjen shoqërore “Kosova Hidroteknika”, si ushtrues i detyrës së drejtorit gjeneral, pastaj si sekretar në ndërmarrjen

s h o q ë r o r e

“Unikosprojekt”, ku aktualisht është duke punuar si drejtor i kompanisë e cila e ka privatizuar këtë ndërmarrje.

Në anën tjetër, Afrim Lajçi, ushtruesi i detyrës së drejtorit aktual, i cili nuk është rekomanduar si njëri prej kandidatëve potencialë për t'u zgjedhur drejtor i ZRRUM,

është me profesion inxhinier i diplomuar i hidrondërtimit dhe në sektorin e shërbimeve të ujësjellësit ka përvojë mbi 20 vjeçare, gjithnjë sipas biografisë së tij të publikuar të ueb faqen e kësaj agjencie.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari,

Kuvendi nuk është pajtuar që Qeveria t'i dërgojë në Kuvend vetëm dy emra, nga një për secilën pozitë, por ka kërkuar që të ketë një mundësi më të madhe zgjedhjeje. Për ta qartësuar këtë situatë është kërkuar opinioni i Zyrës Ligjore të Kuvendit, mirëpo ligji nuk e thotë se sa kandidatë duhet t'ia propozojë Qeveria Kuvendit të Kosovës për miratim

Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka kërkuar që të jetë vetë në gjendje t'i intervistojë kandidatët në njërin prej mbledhjeve të këtij Komisioni. Disa prej anëtarëve të Komisionit kanë shprehur dyshimet se vendimi i Qeverisë nuk është mbështetur në ligj, pasi që Kuvendit sërish i janë dërguar vetëm dy emra

të gatshëm për miratim dhe nuk i është lënë mundësi të zgjedhë në mes të kandidatëve kompetentë.

Komisioni ka konkluduar se vendimin për përzgjedhjen e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të ZRRUM duhet ta marrë Zyra Ligjore e Kuvendit. Ligji nuk e përcakton se sa kandidatë duhet t'i propozojë Qeveria Kuvendit të Kosovës, me qëllim që t'i lihet mundësia Kuvendit për të zgjedhur në mes kandidatëve.

Edhe pse, sipas ligjit, ZRRUM është agjencion i pavarur që i raporton Kuvendit të Kosovës, statusi i

saj i pavarur është i paqartë. Me ligj parashihet që financimi i ZRRUM të jetë i pavarur dhe të hyrat të grumbullohen nga taksat e licencimit, mirëpo deri në fund të vitit 2008 buxheti i ZRRUM është caktuar nga Qeveria, që është në kundërshtim me parimet e pavarësisë së rregullatorëve të pavarur.

## Qeveria i lejon Ministrisë së Bujqësisë rivendosjen e 372.000 eurove

Në mbledhjen e 66-të, mbajtur më 29 maj 2009, Qeveria e Kosovës ka vendosur të transferojë 372.000 euro për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Transferimi bëhet brenda

Zyrtarë të Ministrisë së Bujqësisë kanë bërë të ditur që mjetet do të mundësojnë subvencionimin e aktiviteteve të fermerëve. Ndërkohë që nuk kanë sqaruar pse mjetet janë regjistruar sitë destinuar për projekte kapitale, ata kanë bërë të ditur se kanë

Subvencionet, siç ka bërë të ditur kjo Ministri, do t'u jepen fermerëve në bazë të numrit të gjedheve që ata kanë. Ndiham totale që kjo Ministri planifikon të japë për fermerët gjatë këtij viti është 1.5 milion euro. Sipas zyrtarëve të Ministrisë së Bujqësisë, transferimi i të gjitha mjeteve, me një vendim, nuk është bërë për arsye ligjore, ngase ligji nuk e lejon që më shumë se 25% e mjeteve të transferohen me një vendim të Qeverisë. Pjesa tjetër e mjeteve do të transferohet gjatë vitit.

Transferimi i një shume të tillë të mjeteve nga programi i investimeve kapitale në programin subvencione dhe transfere - tregon për një planifikim të dobët të buxhetit në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë.

Fermerët marrin pjesën e parë të subvencionit 1,5 milionësh. Transferimi i një shume të tillë të mjeteve nga programi i investimeve kapitale në programin subvencione dhe transfere, tregon për një planifikim të dobët të buxhetit në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë

Ministrisë, nga programi për projekte kapitale i Departamentit të Prodhimtarisë Blegtorale, në kategorinë për subvencione dhe transfere.

kërkuar nga MEF-i t'i bartë ato në një linjë të re buxhetore, pra atë për subvencione dhe transfere - për të mundësuar transferimin e tyre tek fermerët.



## Harilaqi i Fushë Kosovës zonë e deponimit të mbeturinave dhe materieve të rrezikshme

Në mbledhjen e saj të 66-të, të mbajtur më 29 maj të vitit 2009, Qeveria e Kosovës ka caktuar Harilaqin e Fushë Kosovës - si lokacion për deponimin dhe magazinimin e mbeturinave dhe materialeve të rrezikshme.

Deponimi i mbeturinave do të bëhet në nëntë parcela, në pronësi shtetërore. Ndërkohë që sipas Qeverisë së Kosovës ky është lokacioni më i sigurt për të bërë deponimin e mbeturinave dhe ai nuk rrezikon jetën e banorëve, zyrtarë të Komunës së Fushë Kosovës, ku pritet të vendoset deponia, kanë pohuar të mos jenë të njoftuar paraprakisht me këtë vendim.

Kosova nuk ka një sistem për menaxhimin e mbeturinave dhe të materieve të rrezikshme. Deri më tash, mbeturinat janë menaxhuar nga kompanitë private, të cilat i kanë prodhuar këto mbeturina dhe materie të rrezikshme, si pjesë e aktiviteteve të tyre.

Sipas vlerësimit të Qeverisë së Kosovës, këto mbeturina

janë hedhur vend e pavend, e edhe në rast të menaxhimit institucional janë ruajtur në kushte mjaft të këqija.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka filluar

vendin më të mirë për ngritjen e një kompleksi objektësh për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave dhe materieve të rrezikshme. Ky rekomandim është miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit

Sipas Qeverisë së Kosovës, kjo zonë paraqet vendin më të sigurt dhe më larg vendbanimeve për deponimin e mbeturinave. Por, zyrtarët e Komunës kanë thënë se do të kërkojnë të informohen se çka nënkuptohet me 'materie të rrezikshme', pasi që, sipas tyre, do të ketë mundësi të ballafaqohen me ankesa të qytetarëve

punën për përzgjedhjen e këtyre lokacioneve në vitin 2007, duke u nisur nga Plani e Kosovës për Veprim në Mjedis për vitet 2004-2010. Deri më tash, Ministria ka përzgjedhur lokacionin për deponimin e mbeturinave dhe ka hartuar projektet për ngritjen e infrastrukturës për këtë deponi.

Grupi punues i Ministrisë ka rekomanduar Kodrën e Goleshit - si

Hapësinor, për të mundësuar më vonë kryerjen e Studimit të Vlerësimit të Ndikimeve Mjedisore të këtij projekti.

Lokacioni alternativ, të cilin e kishte propozuar grupi punues për ruajtjen e mbeturinave, ishte Kazerma në Llukar. Megjithatë, grupi kishte vlerësuar që për të arritur një nivel më të lartë të mbrojtjes nga efektet e mundshme

negative mjedisore të mbeturinave dhe materieve të rrezikshme, do të ishte më mirë nëse deponia do të vendosej në Kodrën e Goleshit.

“Në lokacionin e përzgjedhur, mbeturinat dhe materiet e rrezikshme, sipas Ministrisë së Mjedisit, mund të ruhen në kushte shumë të kontrolluara dhe të jenë të administruara në mënyrë shumë të sigurt, me mundësi të vendosjes së këtyre materieve në vende të ndara sipas karakteristikave të mbeturinave. Lokacioni i përzgjedhur ofron mundësinë që objektet për magazinimin e mbeturinave dhe materieve të rrezikshme me cilësi të caktuara të ndërtohen në largësi të mjaftueshme nga njëra-tjetra”, thuhet më tej në shpjegimin e MMPH-së.

Kjo Ministri ka bërë të ditur se kjo zonë është e shmangur nga vendbanimet, në jugperëndim janë të vendosura majat e kodrës, në verilindje janë disa shtëpi banimi në një largësi prej 1500-2000 metrash, në lindje në një largësi prej 3 kilometrash është i vendosur fshati Harilaq, ndërkaq në veri gjendet rruga. Vendbanimet më të afërta gjenden në një largësi prej 3 kilometrash. Fshati Sllatinë shtrihet në një largësi prej 3.5 kilometrash prej këtij lokacioni.

Kjo deponi ka një sipërfaqe prej 40 hektarësh. Ministria ka tërhequr vërejtjen se një numër investimesh duhet bërë për të krijuar mundësi për shfrytëzimin e këtij lokacioni, si caktimi i kufijve dhe meremetimi i rrugëve të brendshme.

Zyrtarë të Komunës së Fushë

Kosovës, ku pritet të bëhet deponia, kanë bërë të ditur se ata nuk janë njoftuar paraprakisht me këtë vendim. Ata kanë thënë se të paktën kanë të drejtë të informohen për deponimin e substancave që do të bëhet në Komunën e tyre.

“Vendimi është prej Qeverisë së Kosovës. Ne nuk kemi qenë të informuar nga vetë Qeveria, ose nga vetë Kabineti i Kryeministrit. Nuk e dimë sa do të ketë pasoja për banorët, edhe pse i kemi nxjerrë disa fleta poseduese”, është shprehur Ali Topalli, zëdhënës i Komunës së Fushë Kosovës.

Sipas tij, kjo Komunë do të kërkojë të informohet se çka nënkuptohet me ‘materie të rrezikshme’, pasi që, sipas tij, do të ketë mundësi të ballafaqohet me ankesa të qytetarëve.

## Ndihmohet me 7.000 euro familja e dëshmorit të kombit Sami Rama

**Q**ë në fillim të mandatit të tij qeverisës, Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, kishte bërë të qartë se do të ndihmojë kategoritë e dala nga lufta – familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës së UÇK-së dhe veteranët e luftës.

dhe 200 anëtarëve të familjeve të dëshmorëve.

Në shtator të vitit 2008, me vendimin 03/34 Qeveria e Kosovës ndau 150.000 euro për Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, për rregullimin e protezave të

për ndarjen e 7.000 eurove për familjen e dëshmorit të kombit Sami Rama.

Shuma e këtyre mjeteve është 703.510 euro.

Mirëpo, Qeveria e Kosovës ende nuk ka një strategji ose plan veprimi se si t'i qaset problemeve me të cilat përballen këto kategori të dala nga lufta. Të gjitha këto vendime të Qeverisë janë marrë pas kërkesave të bëra nga organizatat e dala nga lufta, e jo në bazë të ndonjë plani paraprak të Qeverisë. Të gjitha këto mjete ndahen nga “Rezervat e paparashikuara të Qeverisë”.

Kuvendi i Kosovës, në vitin 2006, ka miratuar Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës.

Me këtë ligj caktohen ndihmat dhe pensionet për kategoritë e dala nga lufta.

Mirëpo, këto kategori nuk janë të kënaqura me asistencën që marrin nga Qeveria dhe shumë herë kanë protestuar tek Qeveria për ngritjen e shumës së asistencës për këto kategori.

Të gjitha vendimet e Qeverisë për ndarjen e mjeteve financiare për kategoritë e dala nga lufta vijnë si rezultat i kërkesave ad-hoc që bëhen nga shoqatat e dala nga lufta dhe në mungesë të një plani ose strategjie të Qeverisë, këto mjete ndahen nga “Rezervat e paparashikuara të Qeverisë”

Për këtë qëllim, ai themeloi edhe një zyre të posaçme në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Që nga janari 2008, Qeveria e Kosovës ka marrë 6 vendime të ndryshme për ndarjen e mjeteve për ndihmë ndaj kategorive të luftës.

Në maj të vitit 2008, me vendimin 10/22, Qeveria e Kosovës ndau 153.000 euro për Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, për rehabilitimin shëndetësor të 800 invalidëve të luftës së UÇK-së

anëtarëve të saj.

Në janar të vitit 2009, Qeveria ndau 20.000 euro për renovimin e tërësishëm të shtëpisë së dëshmorit Hasan Ramadani.

Në shkurt të vitit 2009, sërish Qeveria ndau 343.510 euro për Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, për rregullimin e protezave të anëtarëve të saj.

Në prill, ndau 30.000 euro për ngritjen e shtatores së dëshmorit Gjeneral Adrian Krasniqi në Pejë.

Dhe, vendimi i këtij muaji, majit,

## Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja

Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Që nga viti 2004, Kosova ka një ligj të tillë, Ligjin nr. 2004/30 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Mirëpo, Qeveria tani ka vendosur që ta zëvendësojë ligjin aktual me një ligj të ri, me arsyetimin se ligji në fuqi nuk i plotëson në tërësi kushtet e Bashkimit Evropian për mbrojtjen a ajrit nga ndotja.

Projektligji i ri ndryshon në masën 60% nga ligji në fuqi. Për këtë arsye, ky ligj konsiderohet si ligj i ri, dhe jo ligj për ndryshim dhe plotësim të ligjit aktual.

Ligji i ri është më voluminoz sesa

si: përcaktimi i vlerave kufitare të emisioneve, normat e emisioneve nga burimet e lëvizshme, emisioni i gazrave serë, etj.

Të gjitha këto akte nënligjore parashihen që të miratohen brenda periudhës 18 mujore, nga dita e hyrjes së ligjit në fuqi. Përpos akteve nënligjore, ligji do të shoqërohet edhe me Strategjinë për Cilësinë e Ajrit dhe Planin e Veprimit, që duhet të hartohen nga Ekzekutivi dhe të miratohen nga Kuvendi; si dhe Planet Lokale të Veprimit që duhet t'i miratojë çdo Kuvend Komunal.

Monitorimi i cilësisë së ajrit bëhet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Projektligji parasheh edhe gjambat për personat fizikë dhe juridikë që nuk u përmbahen dispozitave ligjore. Këto gjomba sillen nga 300 deri në 100.000 euro.

ai në fuqi. Dhe, shumë çështje lihen që të rregullohen me akte nënligjore - në 15 nene të projektligjit thuhet se qartësimi i mëtejme do të bëhet përmes akteve nënligjore.

Sipas Projektligjit, burimet e ndotjes së ajrit janë: 1. Burimet e palëvizshme (impianetetknologjike, pajisjet për procese teknologjike, mihjet sipërfaqësore, etj.); 2. Burimet e lëvizshme të ndotjes që emitojnë ndotje në lëvizje;


3. Burimet e vogla të ndotjes (për shembull, magazinimet e karburanteve, mbetjet e ndotësve të grumbulluara, etj.); 4. Burimet difuzive, të cilat përfshijnë pajisjet, sipërfaqet dhe hapësirat tjera nga të cilat materiet ndotëse përhapen lirshëm në ajër, pa pasur tyntarë ose mjete tjera të shkarkimit.

Çështjet më me rëndësi për mbrojtjen e ajrit nga ndotja janë lënë të rregullohen me akte nënligjore,

Strategjia për Cilësinë e Ajrit do të jetë strategji e veçantë nga Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit, pasi që me ligjin në fuqi Strategjia për Cilësinë e Ajrit inkorporohej në Strategjinë për Mbrojtje të Mjedisit.

Raporti për realizimin e planeve të parashikuara me Strategjinë e Cilësisë së Ajrit i prezantohet Kuvendit të Kosovës nga Qeveria, së paku një herë në vit.

Monitorimi i cilësisë së ajrit bëhet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Projektligji parasheh edhe gjambat për personat fizikë dhe juridikë që nuk u përmbahen dispozitave ligjore. Këto gjomba sillen nga 300 deri në 100.000 euro. Hyrja në fuqi e këtij ligji nuk parashihet që të ketë efekte shtesë buxhetore, pasi që Departamenti për Mjedisin, në kuadër të MMPH, ka buxhetin e ndarë në vlerë prej 2.191.389 eurosh.





## Miratohet Projektligji për Miniera dhe Minerale

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e saj të 66-të, të 29 majit 2009, ka miratuar Projektligjin për Miniera dhe Minerale.

Deri më tash, kjo fushë ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/3 për Miniera dhe Minerale.

Më 21 janar 2005, UNMIK-u kishte shpallur dy rregullore të rëndësishme, që rregullonin fushën e minierave dhe mineraleve: Rregullorja e UNMIK-ut 2005/2 për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, si dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2005/3 për Miniera dhe Minerale.

Rregullorja 2005/2 për KPMM është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin e Kuvendit të Kosovës

nga KPMM. Sipas Projektligjit, asnjë person nuk mund të ushtrojë aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale, ose çfarëdo aktiviteti tjetër, pa licencë ose leje të lëshuar nga KPMM, në përputhje me këtë Ligj.

KPMM mund të lëshojë këto lloje të licencave: licenca për hulumtim, licenca për mbajtjen e të drejtave, licenca për shfrytëzim, leja për ushtrimin e aktiviteteve të veçanta, licenca për shfrytëzim zejtar, licenca ose Leja Diskrecionale.

Projektligji definon kuptimin e këtyre lejeve, kohëzgjatjen e secilës, mënyrën e vazhimit, personat fizikë dhe juridikë që kanë të drejtë të pajisen me këto leje, etj.

Licenca për shfrytëzim për të gjitha mineralet, përveç mineraleve energjetike, jepet në kohëzgjatje maksimale prej 25 vjetësh, si dhe mund të zgjatet edhe për 25 vjet të tjera. Ndërsa, licenca për mineralet energjetike lëshohet për kohëzgjatje deri në 40 vjet, pa mundësi vazhdimi

nr. 03-L081 për KPMM. Miratimi i Projektligjit për Miniera dhe Minerale, që do të zëvendësonte Rregulloren e UNMIK-ut 2005/2 dhe 2005/3, ka qenë kërkesë edhe e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE) 2008.

Sipas PVPE, ky ligj do të duhej të miratohej në pjesën e parë të vitit 2008.

Projektligji për Miniera dhe Minerale ka 88 nene.

Qëllimi i Projektligjit është promovimi i hulumtimeve, nxjerrjes dhe pasurimit të mineraleve, si dhe rregullimi i mbledhjes, menaxhimit dhe arkivimit të të dhënave gjeoshkencore për të mirën e Republikës së Kosovës.

Projektligji përcakton mënyrën e shfrytëzimit të mineraleve në Kosovë, duke përcaktuar llojet dhe procedurat për marrjen e lejeve

Licenca për shfrytëzim për të gjitha mineralet, përveç mineraleve energjetike, jepet në kohëzgjatje maksimale prej 25 vjetësh, si dhe mund të zgjatet edhe për 25 vjet të tjera. Ndërsa, licenca për mineralet energjetike lëshohet për kohëzgjatje deri në 40 vjet, pa mundësi vazhdimi.

Projektligji parasheh edhe të hyrat nga tatimet dhe taksat. Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, pas konsultimit dhe marrjes së pikëpamjeve të KPMM-së dhe palëve tjera të interesuara, përfshirë bartësit ekzistues të licencave ose përfaqësuesit e tyre, bashkërisht përgatisin dhe nxjerrin një propozim listë të tatimeve që bartësit e licencave duhet t'i paguajnë për

ushtrimin e aktiviteteve të licencuara të shfrytëzimit të resurseve minerale në Kosovë. Propozim-lista në fjalë do të përcaktojë në hollësi formulat që duhet shfrytëzuar për llogaritjen e shumës së taniemave. Pasi që lista të jetë përgatitur nga dy Ministritë përkatëse, ato bashkërisht ia dorëzojnë Qeverisë për miratim. Pas miratimit, Qeveria ia dorëzon listën për aprovim Kuvendit.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Miniera dhe Minerale parashihet edhe themelimi i Inspektoratit të Minierave dhe Shërbimit Gjeologjik të Kosovës. Inspektorati i Minierave do të funksionojë në kuadër të KPMM-së. Për funksionimin e tij, nuk nevojiten mjete shtesë buxhetore. Ndërsa, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës do të funksionojë në kuadër të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave. Themelimi i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës do të kërkojë mjete shtesë buxhetore,

ose 102.321 euro në vit.

Dokument me rëndësi në këtë fushë, pas Ligjit për Miniera dhe Minerale, është edhe Strategjia Minerare, e cila do të hyjë në fuqi pas miratimit të këtij Ligji në Kuvend.

Ministria, në bashkëpunim me KPMM-në dhe Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, do të përgatisë dhe dorëzojë për miratim nga Qeveria një Projekt-strategji Minerare që i parashtron synimet dhe planin e zbatimit të rekomanduar nga Ministria për hulumtimin e koordinuar dhe të qëndrueshëm të resurseve minerale në Kosovë, duke marrë parasysh karakteristikat dhe kushtet specifike për secilin rajon, vendburimet e resurseve të caktuara minerale si dhe kushtet për hulumtimin si dhe shfrytëzimin komercial dhe industrial.

Gjatë përgatitjes dhe zbatimit të planeve hapësinore dhe urbanistike,

të gjitha autoritetet publike duhet të marrin parasysh plotësisht dhe të veprojnë në përputhje me Strategjinë Minerare, të shpallur nga Kuvendi.

Strategjia Minerare ka përparësi mbi çdo plan hapësinor ose urbanistik që nuk është në përputhje me të.

Gjatë periudhës para shpalljes nga Kuvendi të Strategjisë Minerare, asnjë autoritet publik nuk mund të miratojë ose zbatojë ndonjë plan hapësinor ose urbanistik pa pëlqimin e Qeverisë. Para dhënies së këtij pëlqimi, Qeveria duhet të këshillohet me Ministrinë. Qeveria duhet ta japë pëlqimin në fjalë përveç nëse Ministria i dorëzon Qeverisë një shpjegim me shkrim, i cili në mënyrë të qartë tregon se zbatimi i një plani të tillë do të ndërhyjë në masë të konsiderueshme me hulumtimin e koordinuar dhe të qëndrueshëm të resurseve minerale në Kosovë.

## Lejohet licencimi i studentëve biologë

Udhëzimi administrativ nr. 10/2003 për Regjistrimin dhe Licencimin e Profesionistëve Shëndetësorë, në nenin 2 të tij parashihte që të drejtë të regjistrimit dhe licencimit do të kenë këto kategori të punëtorëve shëndetësorë: Doktorët e Shëndetësisë, Doktorët e Stomatologjisë, Magjistrat e Farmacisë, specialistët e këtyre drejtimeve, infermierët e diplomuar, fizioterapeutët e diplomuar, mamitë e diplomuara, psikologët klinikë, infermierët dhe teknikët tjerë shëndetësorë nga Regjistri Zyrtar i Bordit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Në këtë udhëzim administrativ nuk parashihej askund licencimi i studentëve të diplomuar të Drejtimit Aplikativ-Inxhinier i Biologjisë/Biokimik-Fiziologjik.

Pas kësaj, stafi akademik dhe studentët e Biologjisë Aplikative dhe Biokimik-Fiziologjik protestuan kundër kësaj urdhërese. Për zgjidhjen e këtij problemi, më 29 janar 2007, Senati i Universitetit të Prishtinës i dorëzoi një kërkesë Kryeministrit të atëhershëm, Agim Çekut. Qeveria e Kosovës, me atë rast, kishte formuar komisionin pesë-anëtarësh, në përbërje prej përfaqësuesve

të Zyrës së Kryeministrit, MASHT, MSH, Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore dhe Fakultetit të Shëndetësisë. Mirëpo, për shkak të zgjedhjeve parlamentare dhe ndërrimit të qeverisjes, puna e këtij komisioni nuk pati ndonjë rezultat. Me funksionalizimin e Qeverisë së re, Rektori Enver Hasani sërisht iu drejtua Qeverisë me një kërkesë për zgjidhjen e këtij problemi.

Qeveria e Kosovës, më 12 qershor 2008, formoi një Komision Profesional, me qëllim të shqyrtimit të planprogrameve mësimore në këtë drejtim, dhe gjetjes së mundësive për licencim. Komisioni përbëhej nga 5 anëtarë dhe në të kishte përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit, MASHT, MSH, Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore dhe Fakultetit të Mjekësisë.

Pas një viti, nga dita kur është marrë ky vendim i Qeverisë, Komisioni ka paraqitur një propozim pranë Qeverisë. Propozimi i Komisionit është miratuar me vendimin 02/63 të 7 majit 2009.

Sipas propozimit të Komisionit Profesional, studentët biologë të Drejtimit Biologji Aplikative (inxhinier i biologjisë) dhe atyre Biokimik-Fiziologjik (shkalla Master), u lejohet licencimi, duke u bazuar në Ligjin për Shëndetësi.

Pas licencimit, studentët e diplomuar të drejtimeve të lartcekura do të marrin titullin laborantë të lartë mjekësorë, kurse të diplomuarit e studimeve Bachelor të Biokimisë-Fiziologjike do të marrin titullin laborantë mjekësorë.

Licencimi do të mund të bëhet vetëm pas plotësimit të disa kushteve shtesë.

Brenda 3 muajve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, Universiteti i Prishtinës do të përpilojë një kurrikulum të ri, me lëndë shtesë nga lëmi i mjekësisë, për studentët e këtyre drejtimeve të Biologjisë. Përveç kësaj, studentët e diplomuar duhet që për 6 muaj të mbajnë praktikë në institucionet shëndetësore. Ministria e Shëndetësisë është e obliguar që zyrtarisht t'i njoftojë të gjitha institucionet shëndetësore që kandidatët e licencuar, në bazë të këtij vendimi, t'i trajtojnë si të gjithë profesionistët tjerë shëndetësorë.

Kjo degë e re e Departamentit të Biologjisë është hapur që nga vitet 1996-1997. Studentët dhe të diplomuarit e mjekësisë gjithnjë kanë kundërshtuar licencimin e studentëve të biologjisë, me arsyetimin se ky licencim i bënë ata të barabartë, kurse kurrikulumet gjatë studimeve janë të ndryshme.



## Qeveria kërkon anulimin e vendimit të Komunës së Lipjanit, por Komuna nuk do

Në fillim të muajit prill, të vitit 2009, Kryetari i Komunës së Lipjanit mori vendim që taksistët që nuk janë të regjistruar në Komunën e Lipjanit – nuk kanë të drejtë të marrin udhëtarë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP), me arsyetim se Aeroporti ndodhet në territorin e kësaj komune. Ky vendim i Kryetarit të Komunës së Lipjanit ngjalli reagim

lokal është kompetencë e komunave, që i njihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, saktësisht neni 17. f. si dhe me Ligjin për Transportin Rrugor, neni 6, i të cilit thotë se “Komuna përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të sigurta, efikase dhe ekonomike brenda kufijve të komunës”, dhe neni 19.2, i cili thotë se “Komuna është përgjegjëse për koordinimin

i Qeverisë nuk e anulon vendimin e Komunës së Lipjanit, por kërkon nga kjo e fundit që vetë të marrë masa për anulimin e tij.

Para marrjes së këtij vendimi, edhe Ministri i Pushtetit Lokal i ka dërguar letër Kuvendit Komunal të Lipjanit, që të shqyrtojë vendimin për taksitë. Me marrjen e këtij vendimi, Qeveria e Kosovës nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme se me çfarë baze ligjore niveli qendror kërkon anulimin e vendimit të nivelit lokal, ose Qeveria e Kosovës nuk jep arsye se çfarë shkeljesh ka bërë Kuvendi Komunal i Lipjanit dhe Kryetari, kur kanë marrë këtë vendim. Komuna e Lipjanit, ndërkaq, ka në favor të saj dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Transportin Rrugor.

Përveç vendimit për operimin e taksive, Komuna e Lipjanit, në muajin prill, ka marrë edhe vendimin për ngritjen e tarifave për punën e kompanive transportuese të udhëtarëve, ku ato janë ngritur nga 7.000 euro në 20.000 euro. Për këtë vendim, Qeveria nuk ka dhënë ndonjë mendim, ashtu sikurse për vendimin e taksive.

Kërkesa për anulim të vendimit nuk mbështetet në ndonjë bazë të qartë ligjore. Në anën tjetër, vendimi i Komunës së Lipjanit bazohet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe në Ligjin për Transportin Rrugor

tek taksistët e Komunës së Prishtinës dhe Fushë Kosovës.

Deri më tash, në ANP kishin të drejtë të operonin edhe taksistët e Fushë Kosovës dhe Prishtinës, në bazë të një marrëveshje të vitit 2004, në mes të këtyre komunave dhe Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit (MTPT). Mirëpo, kësaj radhe, MTPT është shprehur se nuk do të përzihet në këtë mes dhe nuk do të kërkojë rishikimin e vendimit të Kryetarit Shukri Buja.

Rregullimi i çështjes së transportit

dhe rregullimin e transportit urban të rregullt të udhëtarëve me autobus dhe transportit taksi të udhëtarëve”.

Një muaj pas marrjes së vendimit nga Kryetari i Komunës së Lipjanit, Qeveria e Kosovës, më 8 maj, merr një vendim – me të cilin i kërkon Kuvendit Komunal të Lipjanit që të anulojë vendimin për operimin e taksive në ANP. Sipas zëdhënësit të Komunës së Lipjanit, Komuna nuk do ta zbatojë vendimin e Qeverisë së Kosovës, pasi që ai nuk paraqet obligim për Komunën. Vendimi



## Miratohet Projektligji për ndarjen e Dekoratave nga Presidenti

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, njëra nga detyrat kushtetuese të Presidentit të Kosovës është edhe ndarja e dekoratave, mirënjohjeve dhe çmimeve. Kjo e drejtë Presidentit të Kosovës i njihet edhe me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë.

Tash, ndarja e dekoratave nga Presidenti do të rregullohet edhe me ligj.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Dhënie dhe Dekorata nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Sipas projektligjit, Presidenti ka të drejtë të shpërndajë 17 lloje të dekoratave: Urdhri Hero i Kosovës; Medalja e Artë e Lirisë; Medalja e Artë e Pavarësisë; Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit; Medalja Luftëtar i Lirisë Adem Jashari; Medalja e Artë për Paqe, Demokraci dhe Tolerancë Dr Ibrahim Rugova; Medalja Humanitare Nëna Terezë; Medalja e Paqes dhe Pajtimimit Anton

Çetta; Titull Artist i Merituar; Medalja Ushtarake për Shërbim në Kosovë; Dekorata Qytetar Nderi i Kosovës; Dekorata Crystala Dardanica; Çmimi Presidential "E" për Biznes dhe për Shërbim të Eksportit; Çmimi i Presidentit për Siguri; Çmimi Presidential për Studiues; Ambasador Nderi i Kosovës; Trofeu i Presidentit për të arriturat e larta në sport.

Në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Presidentit të Kosovës janë të listuara 25 lloje të ndryshme të dekoratave.

Projektligji ka lënë jashtë listës 8 lloje të dekoratave, si: Ambasador i Kombit të Kosovës; Medalja Mësues i Merituar; Dekorata Qytetar i Merituar i Kosovës; Çmimi Presidential për Inovim, Kërkim dhe Zhvillim; Medalja Civile për Shërbim në Kosovë; Medalja Presidenciale e Meritave; Çmimi Presidential për Cilësi dhe Aftësi të Menaxhimit; Çmimi Presidential për Suksese dhe Prodhim në Biznes; Çmimi Presidential për Meritat e Ambientit.

Projektligji rregullon edhe çështjen se kush ka të drejtë që të propozojë dhënie dhe dekoratave dhe rastet kur Presidenti me vetëiniciativë ndan dekoratat për personalitete të ndryshme.

Presidenti cakton një Komision Vlerësues për dhënie dhe dekoratave.

Gjithashtu, me projektligj parashihet edhe themelimi i Arkivit për Dekorata.

Drafti i projektligjit që është dërguar në Kuvend për miratim nuk parasheh asgjë për dizajnin e dekoratave, si dhe nuk ceket askund se si do të rregullohet pamja e dekoratave dhe medaljeve.

Disa nga dekoratat dhe medaljet kanë edhe stemat e veçantë të cilat mund të shihen nga fotot e mësipërme.

Për periudhën korrik 2009 – 2011, Ligji për Ndarjen e Dekoratave nga Presidenti do të ketë një kosto buxhetore prej 510.000 euro (150.000 euro për vitin 2009, dhe nga 180.000 euro për çdo vit në vazhdim).

## Miratohet Projektligji për Tatimin në të Ardhurat Personale

Vetëm pesë muaj nga dita e hyrjes në fuqi e Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, Qeveria e Kosovës ka miratuar një projektligj për zëvendësimin e tij.

Rregullimi i çështjes së tatimit në të ardhurat personale është bërë përmes një numri rregulloresh të UNMIK-ut që nga viti 2002, ku edhe janë caktuar norma të ndryshme tatimore nga viti në vit (Rregulloret e UNMIK-ut 2002/4, 2003/3, 2004/52 dhe 2007/23).

Deri në janar të vitit 2009, para miratimit nga Kuvendi i Kosovës të Ligjit për të Ardhurat Individuale, norma tatimore në të ardhurat individuale ka qenë e rregulluar në këtë mënyrë: Për të ardhurat e tatueshme 960 euro ose më pak, 0%; Për të ardhurat e tatueshme nga 960 deri 3000 euro, 5%; Për të ardhurat e tatueshme nga 3000 deri 5400 euro, 102 euro plus 10% të shumës mbi 3000 euro; Për të ardhurat e tatueshme mbi 5400 euro, 342 euro plus 20% të shumës mbi 5400 euro. (Shumat dhe përlogaritjet janë bërë në bazë të të hyrave vjetore).

Ligji i Kuvendit të Kosovës për të Ardhurat Individuale ndryshoi këto shkallë tatimore në këtë mënyrë: Norma tatimore 0% mbeti e njëjtë për të ardhurat deri në 960 euro; për të ardhurat nga 960 deri 3000 euro norma tatimore zbriti një shkallë më

pak, 4% të shumës mbi 960 euro; për të ardhurat nga 3000-5400 euro u zvogëlua për dy shkallë, 81.6 euro plus 8% të shumës mbi 3000 euro; dhe për të ardhurat mbi 5400 euro norma tatimore u zvogëlua përgjysmë, 273.6 euro plus 10% të shumës mbi 5400 euro.

Ligji i ri ishte më i favorshëm për ata persona - të ardhurat e të cilëve janë mbi 5400 euro. Por, përveç kësaj, ligji i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2009 - nuk ka bërë asnjë ndryshim tjetër thelbësor nga rregulloret e UNMIK-ut. Edhe Projektligji i ri, i miratuar në Qeveri gjatë muajit maj, i mban të pandryshuara këto norma tatimore. Projektligji i ri, ndër të tjera, synon eliminimin e të metave në legjislacionin e tanishëm në të ardhurat personale, me ç'rast bizneset janë trajtuar ndryshe nga ato që u janë nënshtruar tatimit në të ardhurat e korporatave. Projektligji në të Ardhurat Personale do të jetë më i avancuar edhe në disa aspekte që i trajtojnë çështjet e dividendës, amortizimit, dispozitat e borxhit të keq, etj.

Projektligji i ri synon që të vendosë një tatim gjithëpërfshirës, me qëllim që të avancojë sistemin tatimor në favor të krijimit të një ambienti më të favorshëm për investime, si dhe për afrimi i sistemit të Kosovës me standardet dhe praktikatat më të mira

të BE-së.

Edhe pse projektligji i ri sjell përmirësime thelbësore në legjislacionin aktual, një numër i madh i çështjeve të rëndësishme mbeten të paadresuara qartë në ligj dhe janë lënë të rregullohen më aktet nënligjore.

Projektligji nuk i definon në mënyrë specifike obligimet e qytetarëve të Kosovës, të cilët marrin të hyra nga jashtë vendit, ose të cilët kanë banim të përkohshëm jashtë Kosovës. Kjo çështje është lënë të rregullohet me akte nënligjore. Ministria e Ekonomisë dhe Financave është e obliguar që të nxjerrë edhe këto akte nënligjore që kanë të bëjnë me: përfitimet në gjësende që një punëdhënës ia jep punonjësit që kalon shumën minimale të përcaktuar; kompensimi i shpenzimeve reale të udhëtimeve të biznesit; kërkesat për zbritjen e borxhit të keq; zbritje të tatimit për kontributet humanitare; humbjet tatimore; etj.

Projektligji nuk ka vënë afat se brenda çfarë kohe nga hyrja në fuqi e këtij ligji MEF duhet të nxjerrë aktet nënligjore. Ky lëshim në projektligj nuk do të duhej të lejohej nga Kuvendi i Kosovës, saktësisht nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa.

## Hapen përkohësisht dy pika të reja kufitare në kufirin me Shqipërinë

Me afrimin e sezonit veror, Qeveria e Kosovës ka vendosur të hapë edhe dy pika të reja kufitare me Shqipërinë.

Këto dy pika kufitare do të hapen në Gllloboqicë – Borje dhe në Gorozhub – Pogaj.

Në vendim nuk theksohet se sa kohë do të mbesin të hapura këto dy pika të reja kufitare.

Sipas Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, e miratuar në muajin prill, të vitit 2008, Republika e Kosovës ka 13 pika të rregullta kufitare dhe dy të

përkohshme - në Krushqevë dhe Orqushë.

Po sipas kësaj Strategjie, Republika e Kosovës, në marrëveshje me shtetet relevante fqinje, mund të përcaktojë pika kufitareshtesë, me qëllim të: ushtrimit të aktiviteteve kulturore, sportive, fetare, shkencore, profesionale dhe turistike; reagimet nga fatkeqësitë natyrore dhe rastet emergjente; zbatimit të marrëveshjeve ndër-kufitare; ushtrimit të aktiviteteve bujqësore, blegtorale ose aktivitete të tjera ekonomike.

Në vendimin e Qeverisë së

Kosovës për hapjen e këtyre dy pikave të reja kufitare nuk ceken se për çfarë arsye bëhet hapja e tyre, si dhe nuk përmendet nëse ky vendim është bërë me marrëveshje paraprake me Qeverinë e Shqipërisë.

Kabineti i Ministrave i Republikës së Shqipërisë nuk ka marrë një vendim të ngjashëm për këtë çështje.

Funksionalizimi i këtyre dy pikave kufitare kërkon angazhimin si të palës kosovare, ashtu edhe të asaj të Shqipërisë.



## Kosova merr hapa të njëanshëm për lehtësimin e procesit të liberalizimit të vizave

Më vendimin 03/63 për Miratimin e "Udhërrëfyesit për Implementimin e Kriteve për Procesin e Liberalizimit të Vizave në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian", Qeveria e Kosovës ka miratuar dokumentin e përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme për fillimin e aplikimit të kriteve dhe standardeve që hapin rrugën për liberalizimin e vizave.

Republika e Kosovës formalisht nuk është pjesë e procesit të liberalizimit të vizave për shkak politik, pasi që ende 5 vende anëtare të BE-së nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Ndonëse Kosova nuk është pjesë e marrëveshjes me Komisionin Evropian për Ri-pranimin dhe Lehtësimin e Vizave, MPB ka bërë të ditur që dokumenti do të shërbejë për të plotësuar kriteret teknike të para-anëtarësimit, në mënyrë që sapo të jenë pjekur kushtet politike - ajo të jetë e gatshme të bëhet pjesë e marrëveshjeve me BE-në.

"Duke pasur parasysh se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë iniciuar, ose, madje, janë duke finalizuar përgatitjet për marrëveshjen për liberalizim të vizave, Republika e Kosovës do të dëshironte të avanconte drejt liberalizimit të

vizave, duke përbushur të gjitha kriteret e procesit", thuhet në këtë Udhërrëfyes.

MPB ka vlerësuar se duke mos lejuar Kosovën që të ketë një udhërrëfyes të definuar qartë për liberalizim të vizave, "Komisioni Evropian rrezikon në izolimin e Kosovës, që do të paraqiste rrezik dhe do të destabilizonte më tej Kosovën dhe rajonin".

Katër çështje të cilat do të jenë në fokus të dialogut për liberalizimin e vizave janë: siguria e dokumenteve, migrimi ilegal, rendi dhe siguria publike, si dhe çështjet e marrëdhënieve të jashtme të lidhura me lëvizjen e njerëzve.

Deri më tash, komuniteti evropian ka përfunduar marrëveshjet për lehtësimin e vizave me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Republikën e Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë. Këto marrëveshje kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2009.

Udhërrëfyesi rendit kriteret që Kosova duhet t'i plotësojë, për të filluar dialogun për liberalizimin e vizave. Këtu hyjnë: siguria e dokumenteve, masat për parandalimin dhe adresimin e migrimit ilegal - përfshirë edhe ri-pranimin, miratimin e politikave për azil, menaxhimin e migracionit, parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit, implementimin e konventave ndërkombëtare që

kanë të bëjnë me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet kriminale, bashkëpunimin ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit, mbrojtjen e të dhënave, sigurimin e lirisë së lëvizjes së qytetarëve të Kosovës dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve - përfshirë edhe mbrojtjen e minoriteteve.

Udhërrëfyesi përfshin listën e masave që do të ndërmerren nga Republika e Kosovës, me synim të heqjes së detyrimit për viza.

Republika e Kosovës ka vënë si referencë trendin e ulët të shkallës së refuzimit, që do të duhej të përparonte drejt 3 për qind për viza dhe 1000 persona në vit të refuzuar për hyrjen në zonën e përbashkët të Schengen-it.

Zyrtarë të MPB kanë bërë të ditur që puna për hartimin e planit të veprimit për zbatimin e këtij Udhërrëfyesi pritet të fillojë së shpejti, pas kompletimit të grupit punues me ekspertë dhe njohës të këtij procesi. Sipas zëdhënësit të MPB-së, grupi pritet të përbëhet nga anëtarë të emëruar nga Qeveria e Kosovës, si dhe anëtarë të emëruar nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë. Plani i Veprimit do të finalizohet në çerekun e tretë të vitit 2009. Raporti i Komisionit Evropian, i cili është bërë publik këtyre ditëve, ka përsëritur progresin e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, por me një dozë më afirmative për

Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi.

Një nga kriteret e shumta që Kosova duhet të përmbushë për liberalizimin e vizave me BE-në, është edhe prodhimi i pasaportave elektronike. MPB ka bërë të ditur se është në fazën e kërkimit të konsulentëve për studimin e fizibilitetit për aplikimin e këtyre pasaportave. Ky studim, sipas MPB-së, do të sigurojë bazë reale për tranzicion të sigurt nga dokumentet e tashme kah ato me çip elektronik,

për një afat kohor të arsyeshëm.

“Pas përfundimit të suksesshëm të programit të dokumenteve të reja të Kosovës, MPB është duke u përgatitur në sferën e dokumenteve me çip elektronik ose “e-dokumente”. Duke e ditur kompleksitetin e këtij lëmi, mungesën e ekspertizës në Kosovë nga kjo fushë, si dhe faktin që edhe në suaza evropiane këto zgjidhje teknike janë risi, është paraqitur nevoja për një studim të fizibilitetit në këtë fushë”, ka pohuar Fisnik Rexhepi, zëdhënës i MPB-

së.

Po ashtu, MPB është në proces të instalimit të programit të ri për marrjen dhe përpunimin e të dhënave biometrike. Fillimi i prodhimit të dokumenteve biometrike, sipas kësaj Ministrie, pritet të fillojë në gjysmën e parë të vitit 2010. Në anën tjetër, kostoja e pasaportave aktuale të Republikës së Kosovës ka qenë rreth 1.5 milion euro për 600.000 pasaporta që janë prodhuar deri më tash.

Parametrat sipas të cilëve Komisioni Evropian propozon liberalizimin ose mos-liberalizimin e vizave për një vend të caktuar:

### I. Ri-pranimi dhe Lehtësirat për Viza

- Marrëveshja e Ri-pranimit për Viza.
- Marrëveshja e Lehtësirave për Viza.

### II. Siguria e Dokumentacionit, Migrimi Ilegal, Rendi dhe Siguria Publike, dhe Lidhjet e Jashtme

#### Blloku 1: Siguria e Dokumentacionit

- 1.1 Lëshimi i pasaportave biometrike në pajtueshmëri me standardet e ICAO dhe EC.
- 1.2 Sigurimi i integritetit dhe sigurisë së procesit të personalizimit dhe distribuimit.
- 1.3 Ofrimi i trajnimeve kundër-korrupsionit dhe kodet etike për zyrtarët (pasaporta, viza).
- 1.4 Raportimi i pasaportave të humbura dhe të vjedhura në databazën e Interpol/LASP-it.
- 1.5 Ofrimi i masave të larta të sigurisë për dokumentet identifikuese dhe letërnjoftimet, përfshirë këtu edhe procedurat e lëshimit të këtyre dokumenteve.

#### Blloku 2: Migrimi Ilegal, përfshirë Ri-pranimin

- 2.1.1 Përvetësimi dhe implementimi i legjislacionit përkatës në lëvizjen e personave në kufijtë e jashtëm, dhe legjislacionit për autoritetet kufitare, në pajtueshmëri me Strategjinë Kombëtare për Menaxhim të Integruar të Kufijve 2007.
- 2.1.2 Të ndërmerren masa përkatëse buxhetore dhe të tjera sipas nevojës, për të siguruar efikasitetin e infrastrukturës, pajisjeve dhe sistemeve informative në pikat kufitare.
- 2.1.3 Ofrimi i trajnimeve kundër-korrupsionit dhe kodet etike për zyrtarët (menaxhimi i kufijve).
- 2.1.4 Të finalizohen marrëveshjet e punës me FRONTEX.
- 2.2.1 Përvetësimi dhe implementimi i legjislacionit për përgjegjësitë e agjencioneve transportuese.
- 2.3.1 Përvetësimi dhe implementimi i legjislacionit për azilkërkuesit, në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare.
- 2.3.2 Ofrimi i infrastrukturës adekuate (qendra të pranimit për azilkërkuesit) & përforsimi i organeve përgjegjëse për procedurat e nevojshme për azilkërkuesit.
- 2.4.1 Monitorimi i rrjedhave të shpërnguljes (duke përfshirë profilin migrues), themelimi i organeve kompetente.
- 2.4.2 Implementimi i Strategjisë Ndërkombëtare për Migrim 2005 dhe Planit Veprues.
- 2.4.3 Zhvillimi i zbulimit tokësor, përmirësimi i kapaciteteve për hetimin e migrimit ilegal të organizuar.
- 2.4.4 Përvetësimi dhe implementimi i një ligji për pranimin dhe leje-qëndrimin e shtetasve të huaj.
- 2.4.5 Të sigurohet dëbimi i shtetasve të huaj me qëndrim ilegal në vend.

### Blloku 3: Rendi dhe Siguria Publike

- 3.1.1 Përvetësimi dhe implementimi i një strategjie për luftimin e krimit të organizuar (në veçanti në aspektet ndër-kufitare) duke përvetësuar dhe implementuar një plan veprues.
- 3.1.2 Përvetësimi dhe implementimi i një strategjie dhe planit veprues për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.
- 3.1.3 Përvetësimi dhe implementimi i një strategjie për luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe implementimi i legjislacionit përkatës për konfiskimin e aseteve të kriminelëve.
- 3.1.4 Implementimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit Veprues për Narkotikë 2004-2010, ofrimi i informatave për konfiskimet e drogës dhe personat e përfshirë, si dhe zhvillimi i bashkëpunimit me organet përkatëse ndërkombëtare.
- 3.1.5 Implementimi i Strategjisë Kombëtare kundër Korrupsionit, përvetësimi dhe implementimi i Planit Veprues kundër Korrupsionit, si dhe masave shtesë.
- 3.1.6 Implementimi i konventave përkatëse për OKB-ne dhe Këshillin Evropian, si dhe dhënia e GRECO rekomandimeve në fushat e përmendura më lart dhe në luftën kundër terrorizmit.
- 3.2.1 Implementimi i konventave ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit gjyqësor për çështjet kriminale.
- 3.2.2 Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor për çështjet kriminale me shtetet e BE-së dhe ato rajonale.
- 3.2.3 Zhvillimi i marrëdhënieve të punës me Eurojust.
- 3.3.1 Përmirësimi i bashkëpunimit në fushën e zbatimit të ligjit ndërmjet agjencioneve kombëtare përkatëse.
- 3.3.2 Ndërtimi i mekanizmave të bashkëpunimit për shkëmbimin e informatave ndërmjet agjencioneve kombëtare.
- 3.3.3 Përmirësimi i bashkëpunimit në fushën e zbatimit të ligjit dhe shkëmbimit të informatave me shtetet e BE-së.
- 3.3.4 Përmirësimi i kapaciteteve operacionale dhe hetuese të shërbimeve për zbatimin e ligjit për t'u ballafaquar me krimin ndër-kufitar.
- 3.3.5 Përgatitja për finalizimin e marrëveshjes për bashkëpunim operacional me Evropol.
- 3.4.1 Implementimi i Ligjit për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale (Mars 2008), themelimi i autoritetit mbikëqyrës.
- 3.4.2 Nënshkrimi, ratifikimi dhe implementimi i konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale.

### Blloku 4: Lidhjet e Jashtme dhe të Drejtat Themelore

- 4.1.1 Sigurimi i lëvizjes së lirë të qytetarëve, pa diskriminim.
- 4.2.1 Sigurimi i qasjes në dokumentet e identitetit dhe atyre të udhëtimit për të gjithë qytetarët.
- 4.2.2 Sigurimi i qasjes në dokumentet e identitetit për refugjatët.
- 4.3.1 Përvetësimi dhe zbatimi i legjislacionit kundër diskriminimit.
- 4.3.2 Specifikimi i kushteve dhe rrethanave për marrjen e nënshtetësisë së Shqipërisë.
- 4.3.3 Sigurimi i hetimit të incidenteve me motive etnike në fushën e lirisë së lëvizjes.
- 4.3.4 Sigurimi i mbikëqyrjes së dispozitave të Kushtetutës për mbrojtjen e minoriteteve.
- 4.3.5 Implementimi i politikave përkatëse rreth minoriteteve, përfshirë edhe romët.

#### Vërejtjet Përfundimtare

- Norma e refuzimit të vizave dhe norma e refuzimit të hyrjes.
- Implementimi i veprimeve të përbashkëta të BE-së rreth ndalesave në udhëtime.



## Programi "Diaspora" mobilizon Ministrinë e Punëve të Brendshme

Qeveria e Kosovës sërish ka marrë masa që të furnizojë diasporën dhe të gjithë të tjerët me dokumente personale, gjatë sezonit veror. Këtë mobilizim e ka quajtur programi "Diaspora".

Për këtë qëllim, në mbledhjen e 66-të të Qeverisë, janë marrë dy vendime: Vendimi 05/66 për pranimin e praktikantëve, si dhe Vendimi 17/66 për orarin e zgjatur të punonjësve të MPB-së.

Për të realizuar programin "Diaspora", 485 punëtorë të MPB-së, për tre muaj, do të punojnë me orar të zgjatur. Duke filluar nga 1 qershori e deri më 31 gusht, punonjësit e Departamentit të Prodhimit të Dokumenteve (176 punëtorë),

Departamentit të Regjistrimit dhe Gjendjes Civile (240 punëtorë) dhe Departamentit të Regjistrimit të Automjeteve dhe Patentë-shoferëve (69 punëtorë), do të jenë të angazhuar nga 11 orë në ditë, si dhe 8 orë ditëve të shtuna. Për këtë, ata do të marrin nga 200 euro shtesë në muaj, për punë jashtë orarit. Për tre muaj, nga Buxheti i Kosovës do të ndahen 291.000 euro për punë jashtë orarit.


Ky program është zbatuar edhe gjatë vitit 2008, ku nga 1 korriku 2008 e deri më 28 shkurt 2009, 406 punonjës të MPB-së kanë punuar me të njëjtin orar të shtuar. Por, përkundër kësaj, sërish nuk ka qenë mundur të evitohen radhët e gjata në sportelet e komunave, e diaspora

është përballur me probleme të natyrave të ndryshme.

Por, këtë vit, përveç që do të punohet edhe jashtë orarit, kësaj here do të angazhohen edhe praktikantë për t'u ndihmuar punonjësve të MPB-së. Sipas zyrtarëve të MPB-së, si praktikantë do të angazhohen studentët e Fakultetit Juridik. Për këtë qëllim, më 18 qershor do të nënshkruhet një marrëveshje mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Fakultetit Juridik, për angazhimin e 65 studentëve si praktikantë me pagesë, dhe 35 studentëve nga Fakulteti i Elektros. Pagesa për praktikantët do të jetë 100 euro në muaj. Praktikantët do të angazhohen për një periudhë tremujore.

Për të lexuar të gjithë numrat e publikimit, bashkë me publikimet e tjera të Institutit GAP, na vizitoni në faqen: [www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Prej tani, mbi zbatueshmërinë e vendimeve të muajve të kaluar, do të mund të lexoni në webfaqen e Institutit GAP [www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)



## PËRMBLEDHJE | Vendimet e Qeverisë së Kosovës

Në muajin maj të vitit 2009, Qeveria e Kosovës ka mbajtur katër mbledhje të rregullta: mbledhjet 63, 64, 65 dhe 66. Në mbledhjen e 65-të të Qeverisë nuk është marrë asnjë vendim. Më poshtë, janë të renditura të 23 vendimet, ashtu siç janë marrë në Qeveri, në formë kronologjike:

- 1. Vendimet nga mbledhja e 63-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 7 maj 2009:**
  - 1.1 Vendimi 02/63 për mbështetjen nga Qeveria e Republikës së Kosovës për propozimin të Komisionit qeveritar për problemin e licencimit të studentëve biologë.
  - 1.2 Vendimi 03/63 për Miratimin e Udhërrëfyesit për Implementimin e Kritereve për Procesin e Liberalizimit të Vizave në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
  - 1.3 Vendimi 04/63 për Miratimin e rekomandimeve të dala nga procesi i rishikimit funksional dhe organizimit institucional.
  - 1.4 Vendimi 05/63, Qeveria e Kosovës ia rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidatët për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor të Zyrës Rregullative të Ujësjiellit dhe Mbeturinave.
  - 1.5 Vendimi 06/63, ndahen mjete financiare në vlerë prej 7.000 (shtatë mijë) euro për familjen e dëshmorit të kombit, Sami Rama.
  - 1.6 Vendimi 07/63, përcaktohet niveli maksimal i shpërndarjes së mjeteve financiare për skemën e "Fondit të Trurit", të miratuar me vendimin 02/48, të 24 dhjetorit 2008.
- 2. Vendimet nga mbledhja e 64-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 8 maj 2009:**
  - 2.1 Vendimi 01/64, Kërkohet nga Kuvendi Komunal i Lipjanit që të shfuqizojë vendimin lidhur me të drejtën e operimit të taksive në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.
- 3. Vendimet nga mbledhja e 66-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 29 maj 2009:**
  - 3.1 Vendimi 02/66 për Miratimin e transferimit të mjeteve financiare për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në shumën prej 372.000 euro.
  - 3.2 Vendimi 03/66, të iniciohet procedura për hartimin e Strategjisë Nacionale për Grumbullimin e Armëve të Paligjshme.
  - 3.3 Vendimi 04/66, të iniciohet procedura për hartimin e Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Krimit.
  - 3.4 Vendimi 05/66 lejon angazhimin e praktikantëve me pagesë, me qëllim të shtimit të kapaciteteve në qendrat komunale të Regjistrimit Civil dhe në Departamentin e Prodhimit të Dokumenteve.
  - 3.5 Vendimi 06/66, të bëhet hapja e përkohshme e dy pikave kufitare me Republikën e Shqipërisë.
  - 3.6 Vendimi 07/66, lokacioni për deponimin dhe magazinimin e mbeturinave dhe materieve të rezykshme caktohet në Komunën e Fushë Kosovës, Komuna kadastrale Harilaq, parcela kadastrale në pronësi shtetërore nr. 5, 7, 10, 11, 12, 13, 15, 22, dhe 24 fleta poseduese Nr. 149.
  - 3.7 Vendimi 08/66, i lejohej Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. që të bëjë shpronësimin dhe kompensimin e pronës dhe pasurisë së banorëve të fshatit Hade, të ngastrave kadastrale të lagjes Shalaj, sipas dinamikës së zgjerimit – zhvillimit të Mihjes së Sibovcit Jugperëndimor, sipas tabelës së parcelave të paraqitura në aneks, bashkangjitur këtij vendimi.
  - 3.8 Vendimi 09/66 për Miratimin e Udhëzimit Administrativ për Amendamentimin e Udhëzimit Administrativ nr. 18/2005 për Kontrollin Veterinar të Importimit, Kalimit Transit të Produkteve Ushqimore dhe Joushqimore me Origjinë Shtazore të Kafshëve të Gjalla dhe të Materialit për Mbarështimin e Kafshëve.
  - 3.9 Vendimi 10/66 për Miratimin e Projektligjit për Dhënien e Dekoratave nga Presidenti.
  - 3.10 Vendimi 11/66 për Miratimin e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Duhanin nr. 02/L-36.
  - 3.11 Vendimi 12/66 për Miratimin e Projektligjit për Miniera dhe Minerale.
  - 3.12 Vendimi 13/66 për Miratimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-99 për Prokurim Publike në Kosovë Nr. 2003/17.
  - 3.13 Vendimi 14/66 për Miratimin e Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.
  - 3.14 Vendimi 15/66 për Miratimin e Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale.
  - 3.15 Vendimi 16/66 për Miratimin e Projektligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.
  - 3.16 Vendimi 17/66 për Miratimin e Planit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për shtimin e orarit ditor të punës në 11 orë dhe aplikimi i orarit 8 orësh të punës, të shtunave, në Departamentin e Prodhimit të Dokumenteve, në Departamentin e Regjistrimit dhe Gjendjes Civile, dhe në Departamentin e Regjistrimit të Automjeteve dhe Patentë-Shoferëve, me qëllim të realizimit të programit "Diaspora".



GAP Monitor është publikim i përmuajshëm i Institutit për Studime të Avancuara GAP. Ky numër është përgatitur nga:

Agron Demi, agron@institutigap.org; Rudina Heroi, rudina@institutigap.org;

Antigona Berisha, antigona@institutigap.org, Florina Hajdini dhe Kreshnik Berisha, keka@institutigap.org.

Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Rr. Nëna Terezë 41/29, 10000 Prishtinë, Kosovë | +381 38 224 145 | monitor@institutigap.org | www.institutigap.org